



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2019

SESIONI I

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT- ORIENTUESE

Varianti B

Lënda: Gjuhë shqipe dhe Letërsi (Shkollat e orientuara)

Në vëmendje të maturantëve

Maturantë,

Ju mund t'i referoheni skemës së vlerësimit të publikuar nga QSHA, për të verifikuar saktësinë e përgjigjeve tuaja në provimin e gjuhës shqipe dhe letërsisë. Por, në mënyrë që skema t'ju vijë në ndihmë për të qenë sa më të qartë për arritjet tuaja në provim, duhet të keni parasysh:

- Skema e korigjimit është orientuese (siç parashtrohet edhe në emërtimin e skemës në krye të saj). Kjo do të thotë që:
 - ✓ *për pyetjet me alternativa*, ka vetëm një përgjigje të saktë; të tjerat, edhe pse mund të jenë të përafërta me përgjigjen e saktë, janë të gabuara;
 - ✓ *për pyetjet e hapura*, përgjigjet në skemë nuk janë shtruesë, për shkak se shpjegimi apo interpretimi nuk mund të parashkruhet, i plotë dhe i zbërthyer deri në detaje, në një skemë të tillë përmbledhur.
- Gjatë ballafaqimit të përgjigjeve tuaja me përgjigjet në skemë, lexoni me kujdes shënimet për pyetjet me zhvillim, të cilat sqarojnë që përgjigjet tuaja do të vlerësohen me pikë edhe nëse nuk janë pikëpërpikë si përgjigjet që parashikohen në skemë, mjaft që komisioni i vlerësimit t'i pranojë ato si të sakta.

Shpresojmë që sqarimet e mësipërme do t'ju ndihmojnë të fitoni qetësinë e nevojshme në pritje të rezultateve të provimit të shpallura nga QSHA.

Suksese!

PJESA I*Sonata*

Pyetja 1	A	1 pikë
Pyetja 2	D	1 pikë
Pyetja 3	D	1 pikë
Pyetja 4	C	1 pikë

Pyetja 5 **2 pikë****Teza:**

- Muzika është jo vetëm një sipërmarrje e lashtë njerëzore, por edhe një formë arti me interpretues virtuozë nga mbretëria e kafshëve.

OSE

- Muzika është veprimtari jo vetëm njerëzore, por shtrihet edhe shumë më gjerë.

OSE

- Njerëzit e kanë zhvilluar “instinktin muzikor”, pasi janë ndikuar nga modelet e hasura në botën e kafshëve.

Argumente:

- Njerëzit, edhe qindra-mijëra vjet më parë, dinin t’i modelonin instrumentet muzikore, muzika e të cilave ngjason me gagaritjen e rosave.

OSE

- Madhështia e zërit, nuk është një cilësi vetëm e njeriut por edhe e një numri kafshësh.

1 pikë Nëse identifikon tezën.

DHE

1 pikë Nëse gjen një argument në mbështetje të saj.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 6 **3 pikë****Lloji:**

- informues-paraqitës/ shpjegues.

Karakteristikat:

- gjuhë objektive, e drejtpërdrejtë, e qartë, e saktë, pa ngjyrimë emocionale;

OSE

- leksik i specializuar, me terma teknikë të fushës përkatëse: *biomuzikë, antropologji, struktura të shumëfishta të trurit njerëzor, “instinkt muzikor”*;

OSE

- gjuhë faktike: kemi prezencën e referencave e përkufizimeve: *“Është shumë e thjeshtë të luajmë këngë të pastra, të papërpunuara balenash”, - thotë dr. Grei, e cila ka shkruar një pjesë për saksofon, piano dhe balena.*, apo shpjegim të kuptimit të fjalëve: *biomuzikë, dega që studion bazat biologjike për krijimin dhe vlerësimin e muzikës*;

OSE

- fjali të përbëra, me pjesë të lidhura me konektorë të natyrave të ndryshme, që nxjerrin në pah marrëdhëniet mes koncepteve;

OSE

- konektorë që sigurojnë lidhjen koherente të paragrafëve (*në fakt, gjithashtu, për shembull*);

OSE

- folje në të tashmen e dëftores (*kanë arritur*) dhe lidhores si dhe në të kryerën e dëftores, për ta paraqitur informacionin si aktual dhe gjithmonë të vlefshëm.

1 pikë Nëse identifikon llojin e tekstit.

DHE

2 pikë Nëse identifikon dy karakteristika gjuhësore bashkë me ilustrimin përkatës.

OSE

1 pikë Nëse identifikon një karakteristikë gjuhësore bashkë me ilustrimin përkatës.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim: Nëse ilustrimi mungon, nxënësi nuk do të marrë pikë për këtë pjesë të pyetjes.

Pyetja 7 **3 pikë****Informacionet:**

- Zbulimet e instrumenteve muzikore në Francë dhe në Slloveni, të cilat datojnë rreth 53 000 vjet më parë.

OSE

- Këto zbulime janë dy herë më të vjetra se vizatimet e lashta të zbuluara në shpella.

OSE

- Instrumentet janë flaute të gdhendura në kocka kafshësh.

OSE

- Studiuesit konstatuan se këto vegla muzikore lëshonin tinguj të ëmbël, të ngjashëm me gagaritjen e rosave.

Qëllimi:

- Për të mbështetur argumentin e shtruar në këtë paragraf.

OSE

- Për ta bërë më të besueshëm argumentin.

2 pikë Nëse identifikon dy informacione.

OSE

1 pikë Nëse identifikon një informacion.

DHE

1 pikë Nëse tregon qëllimin e përdorimit të tij.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 8 **1 pikë****Si i mbajnë mend balenat?**

- balenat përdorin ritme dhe fraza muzikore;
- balenat procedojnë me intervale muzikore;
- balenat këndojnë me nota;
- balenat ndjekin një mënyrë të pëlqyer të këngëtarëve, të quajtur forma A-B-A, në të cilën ka një temë që, më pas, përpunohet dhe, në fund, rikthehet në një formë më të modifikuar;
- balenat në këngën e tyre më emocionuese kanë një refren që rimon;
- balenat përdorin rimën, ashtu si edhe ne.

1 pikë Nëse zbulon një rast që tregon se si i mbajnë mend balenat materialet e tyre komplekse.**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.**Pyetja 9** **1 pikë****Pse mund të luajmë këngë balenash?**

- Këngët e balenave janë **të thjeshta** dhe **të kuptueshme** nga njerëzit.

1 pikë Nëse tregon pse njerëzit mund të luajnë këngë balenash.**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.*Pllakat*

Pyetja 10	A	1 pikë
Pyetja 11	D	1 pikë
Pyetja 12	C	1 pikë
Pyetja 13	B	1 pikë
Pyetja 14	B	1 pikë
Pyetja 15	C	1 pikë
Pyetja 16	C	1 pikë
Pyetja 17	A	1 pikë
Pyetja 18	C	1 pikë
Pyetja 19	D	1 pikë

PJESA II**Naim Frashëri*****Bukuria***

Pyetja 20	D	1 pikë
Pyetja 21	C	1 pikë
Pyetja 22	D	1 pikë

Pyetja 23 **2 pikë****Mbështetja në krijimtarinë popullore dhe ilustrimi:**

- Figuracioni: si thëllëzë/ të keqen e këmbës sate/ të' iu bëfsha atij syri/ E leshrave si tërtërë./E qepallës si gjilpërë;

OSE

- Koncepti për të bukurën dhe dashurinë: vasha është *si thëllëzë*, me një *shtat të florinjtë*, me leshrat *si tërtërë*, me qepallat si gjilpërë; dashuria të lë pa gjumë: *Po ta lerë dhe pa gjumë*;

OSE

- Lloji i vargut (8 rrokësh): *Qiriri meje ka mësuar*, etj.

1 pikë Nëse identifikon një rast të ndikimit nga poezia popullore.**DHE****1 pikë** Nëse e ilustron me një shembull idenë e dhënë.**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 24 (a) 2 pikë**Vargjet konkrete:**

*O more shtat i florinjhtë,
Bukuria teje buron
Edhe të rrjedh nga pëqinjtë,
Gjithë jetën e sbukuron.*

Ideja e Naimit:

- Bukuria dhe dashuria janë **të pandara** dhe rrjedhin nga njëra-tjetra.

OSE

- Uni lirik dashuron bukurinë.

OSE

- Aty ku ka dashuri, ka patjetër edhe bukuri; ato janë të shkrira me njëra-tjetrën dhe shtrihen në hapësirë dhe në kohë.

1 pikë Nëse identifikon një rast ku shfaqet raporti midis bukurisë dhe dashurisë.

DHE

1 pikë Nëse shpjegon idenë e Naimit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 24 (b) 3 pikë**Natyra e unit lirik:**

- Ai është shumë i ndjeshëm, i dashuruar pas objektit të dashurisë, ai e adhuron atë dhe nënshtrohet deri në vetëflijim, i butë dhe i dorëzuar përballë pushtetit të dashurisë.

OSE

- Ai është aq i ndjeshëm sa tek vuajtjet e dashurisë gjen kënaqësinë e sakrificës më sublime.

OSE

- Ai është i dobët, përballë një dashurie nga e cila nuk merr përgjigje.

Raporti i tij me objektin e dashurisë:

- Uni lirik qëndron në pozita pasive.
- Uni lirik është vëzhgues i jashtëm i objektit të dashurisë.
- Uni lirik nuk krijon raporte të ndërsjella me objektin e dashurisë.

Ilustrimi:

- *heth një shkëndijë/ Dhe zëmrënë ma përvëlon.*
- *Që në zëmërë më hyri/ Ç'pate që më vrave, ç'pate?*

1 pikë Nëse zbulon natyrën e unit lirik

DHE

1 pikë Nëse tregon raportin që ai ka me objektin e dashurisë.

DHE

1 pikë Nëse mendimin e ilustron me vargje.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 25 (a)**2 pikë****Kuptimi:**

- Në strofën e parë zjarri shfaqet si simbol poetik.

Shpjegimi:

- Ai është zjarri i dashurisë, i vuajtjes, i dëshirës, i vetësakrificimit.

OSE

- Është flaka që përvëlon shpirtin e unit lirik, që i jep dhimbje por edhe kënaqësi.

1 pikë

Nëse zbulon kuptimin që mbart *zjarri*, në strofën e parë të poezisë.

DHE**1 pikë**

Nëse zberthen kuptimin që merr kjo simbolikë, në strofën e parë.

0 pikë

Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 25 (b)**2 pikë*****Përgjigje plotë***

- Vasha përqaset me trëndafilin: çelet, lulëzohet, qeshet dhe zbukurohet. Ashtu si trëndafili që xhelozon bilbilin, e bën të pëlçasë, nuk i flet, është i pamëshirshëm, po ashtu sillet ajo me heroin lirik. Ky i fundit si bilbili, përvëlohet (vuan), rri pa gjumë, por edhe kënaqet nga kjo vuajtje.

OSE

- Gjendja e vuajtjes dhe kënaqësisë së unit lirik, në raportin e dashurisë për vashën, është analoge me atë të bilbilit për trëndafilin. Vasha është indiferente ndaj dashurisë së unit lirik.

Përgjigje e pjesshme

- Ka një analogji midis trëndafilit dhe bilbilit nga njëra anë dhe vashës dhe unit lirik nga ana tjetër.

OSE

- Vasha përqaset me trëndafilin dhe e bën heroin lirik të vuajë.

OSE

- Heroi lirik përqaset me bilbilin dhe vuan prej indiferencës së vashës.

2 pikë Nëse shpjegon në mënyrë të plotë simbolikën midis dy raporteve.

1 pikë Nëse shpjegon në mënyrë të pjesshme simbolikën midis dy raporteve.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Viktor Hygo***Katedralja e Parisit***

Pyetja 26 **B** **1 pikë**

Pyetja 27 **D** **1 pikë**

Pyetja 28 **D** **1 pikë**

Pyetja 29 **3 pikë****Gjendja shpirtërore:**

- Kuazimodo ndihet i dëshpëruar, i trishtuar. Dhe ky trishtim është në shkallën maksimale, përse kohë ai e shfaq duke shkukur flokët.

Çfarë e ka shkaktuar?***Përgjigje e plotë***

- Ai e kupton se Esmeralda nuk do ta dojë kurrë, për shkak të shëmtimit të tij fizik. Ndjenjat e saj janë për Febysin. Ajo s'ka për ta parë kurrë Kuazimodon në atë mënyrë që sheh Febysin dhe s'do të përjetojë kurrë ndjenja dashurie për të.
Ky ndërgjegjësimit për të vërtetën e tmerrshme e bën atë të vuajë.

Përgjigje e pjesshme

- E ndjen se Esmeralda nuk do ta dojë kurrë, sepse është i shëmtuar.

1 pikë Nëse tregon gjendjen shpirtërore që po kalon Kuazimodo.

DHE

2 pikë Nëse shpjegon **në mënyrë të plotë** se çfarë e ka shkaktuar atë.

OSE

1 pikë Nëse shpjegon **në mënyrë të pjesshme** se çfarë e ka shkaktuar atë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 30 **3 pikë****Figura e stilistikës:**

- Krahasim i zgjeruar/ similitudë.

Shpjegimi:***Përgjigje e plotë***

- Esmeralda është në kulmin e dëshpërimit. E marrosur pas Febysit, ajo torturohet për një gjest apo për një fjalë nga djaloshi, të cilit duket se nuk i intereson vajza. Ndjenja e Esmeraldës është kaq e fortë, sa ajo dëshpërimisht dhe e torturuar nga ndjenja e dashurisë, ashtu si i mbyturi që kërkon shpëtim, kërkon vëmendjen, ndjenjën e njeriut që do.

OSE

- Analogjia është shumë e fortë, tipike romantike: Esmeralda përqaset me të mbyturin (e torturuar nga ndjenja e saj) ndërsa Febysi është si anije e qetë, i largët, i paprekshëm për të, shkëlqimtar, i paarritshëm.

OSE

- Është një përshkrim tipik romantik: heroi i jashtëzakonshëm në rrethana të jashtëzakonshme. Ajo, si i mbyturi kërkon shpëtim; Febysi, si një anije e qetë dhe që mbart shpresën e shpëtimit, mbetet gjithsesi i largët, si për të na paralajmëruar për ç'do të vijoje më pas.

Përgjigje e pjesshme

- Krahasimi i zgjatur krijon analogjinë midis Esmeraldës me të mbyturit dhe Febysit me anijen.

OSE

- Esmeralda është si i mbyturi në det që kërkon shpëtim te Febysi.

1 pikë Nëse identifikon figurën e stilistikës.

2 pikë Nëse shpjegon në mënyrë të plotë imazhin e krijuar.

OSE

1 pikë Nëse shpjegon në mënyrë të pjesshme imazhin e krijuar.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 31 **2 pikë*****Përgjigje e plotë***

- Viktor Hygo ka krijuar një botë në të cilën personazhet zotërohen nga pasioni, një botë në të cilën e mira ekziston krahas së keqes, djallëzores dhe askush nuk dëshiron ta shikojë të bukurën në thelbin e qenies njerëzore. Kuazimodo i mirë, por i shëmtuar, zotërohet nga një ndjenjë e fuqishme për Esmeraldën. Pasioni e shtyn atë të shkelë edhe mbi ndjenjat e veta. Esmeralda e bukur dhe e mirë, dashuron marrëzisht Febysin. Ky i fundit, i bukur, por i shëmtuar në shpirt, nuk do askënd dhe shkel mbi çdo gjë të bukur. Esmeralda shikon vetëm bukurinë të Febysi, por jo shpirtin e tij. Ky pasion po e çon atë drejt shkatërrimit. Sikurse ajo nuk dallon dot të bukurën në shpirtin e Kuazimodos.

OSE

- E bukura (së jashtmi) nuk i shpëton njerëzit, nuk i bën më të mirë, përkundrazi, ajo nxit pasione që i shtyjnë në gabime fatale, sikurse ndodh me Esmeraldën. Edhe njerëzit që janë të aftë të përjetojnë ndjenja të thella (Kuazimodo, Esmeralda), kërcënohen nga shkatërrimi, pikërisht, për shkak të ndikimit që ka bukuria e jashtme tek ata.

OSE

- E mira dhe e keqja janë kaq të ndërthurura me njëra-tjetrën, sa njerëzit nuk e shohin dot diferencën midis tyre. Dhe në botë ka një betejë konstante midis së mirës dhe së keqes. E mira shfaqet e dobët, e brishtë e prirur për t'u shkatërruar, siç pritet të ndodhë me Kuazimodon dhe Esmeraldën.

Përgjigje e pjesshme

- Personazhet përqendrohen thjesht tek bukuria e jashtme.

OSE

- Kuazimodo është i shëmtuar nga jashtë, por me shpirt të bukur.

OSE

- Esmeralda nuk e vë re shpirtin e bukur të Kuazimodos.

2 pikë Nëse analizon **në mënyrë të plotë** shkrirjen midis së mirës dhe së keqes.

1 pikë Nëse analizon **në mënyrë të pjesshme** shkrirjen midis së mirës dhe së keqes.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 32 **3 pikë*****Përgjigje e plotë***

- Kuazimodo është një figurë tipike romantike: është thellësisht i shëmtuar fizikisht, por nga ana tjetër është figura që shfaq edhe ndjenjat më të forta njerëzore. Në këtë fragment, si edhe në të gjithë romanin, ai mbetet nga të vetmit që është në gjendje të dashurojë thellësisht dhe të bëjë shumë gjëra, jo për veten, por për hir të dashurisë. Dashuria e Kuzimodos është edhe pasionante, edhe shprehje e aftësisë për të sakrifikuar veten, pa kërkuar asgjë në këmbim.

OSE

- Kuzimodo është figura që mbart kontrastin më të fuqishëm në të gjithë romanin: atë midis dukjes dhe thelbit. Në të mbijetojnë të dyja: e bukura dhe e shëmtuara. Ai dashuron fort dhe ndjenja e tij është aq e fuqishme, sa ai mohon edhe veten e tij.

OSE

- Ai është heroi tipik romantik, që vepron në situata të jashtëzakonshme: e adhuron Esmeraldën dhe është gati të shkelë mbi ndjenjën e tij, vetëm që ajo të jetë e lumtur. Një lumturi që Kuazimodon e vret shpirtërisht, askush s'i shikon lotët e tij, dramën e tij. Kjo e bën një hero të jashtëzakonshëm që vendoset në situata po të tilla.

Përgjigje e pjesshme

- Figura e Kuazimodos mbart një kontrast të fuqishëm: pamja e jashtme dhe bota e brendshme.

OSE

- Kuazimodo është njeri që mbart pasione të fuqishme.

Ilustrime:

- *Ah, i mjeri unë! Ja si duhet të jetë njeriu: të jetë i bukur nga jashtë!*
- *Por shurdhi i varfër dëgjonte dhe befas një psherëtimë e thellë ia çoi kraharorin peshë.*
- *Fytyra e tij ishte e qetë - Ai tundte kokën me hidhërim (kontrasti).*
- *Syri i kambanarit fatzi u mbush me lot, por ai nuk i linte t'i rridhnin faqeve.*

2 pikë Nëse argumenton **në mënyrë të plotë** pse është figurë romantike.

OSE

1 pikë Nëse argumenton **në mënyrë të pjesshme** pse është figurë romantike.

DHE

1 pikë Nëse mendimin e ilustron me shembuj nga fragmenti.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 33 **8 pikë**

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË**2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese, ku argumenton nëse adoleshentët janë ose jo të pakujdesshëm në raport me vendimet që marrin;
- përdor shembuj dhe ilustrime, fjalë kyç etj, për të mbështetur idenë e tij mbi raportin e krijuar, duke iu referuar përvojës personale ose edhe përvojave të të tjerëve;
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË**2 pikë****1 pikë** **Struktura e esesë**

- respekton elementet e strukturës së esesë:
 - hyrjen;
 - zhvillimin (argumentin/argumentet);
 - përfundimin.

Nxënësi merr **1 pikë**, nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

1 pikë **Organizimi i esesë**

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla, si: koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme nga njëri paragraf te tjetri).

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI**2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë;
- shprehet me një gjuhë eseistike argumentuese, bindëse, subjektive;
- ka fjalor të pasur;
- ka stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE**2 pikë****(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore;
- ndërton fjali të sakta dhe të qarta;
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm;
- ka saktësi drejtshkrimore.